



BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

2021

REMITANCAT DHE RËNDËSIA E TYRE PËR INDIVIDIN DHE EKONOMINË

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
dhe Grupi i Bankës Botërore
me mbështetjen e
Qeverisë së Zvicrës



THE WORLD BANK
IBRD • IDA | WORLD BANK GROUP

Kjo broshurë është një produkt i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës dhe Grupit të Zhvillimit të Sistemeve të Pagesave (PSDG) në Praktikën Globale të Financave, Konkurrencës dhe Inovacionit të Grupit të Bankës Botërore.

Sekretariati Shtetëror i Çështjeve Ekonomike (SECO) i Zvicrës siguroi fonde për materialin në kontekstin e Programit të Remitancave dhe Pagesave.

www.remittanceprices.worldbank.org



Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Adresa: Rr. Garibaldi nr. 33,
Prishtinë, Kosovë

www.bqk-kos.org

E-mail: info@bqk-kos.org

Telefon: +383 38 222 055

Fax: +383 38 243 763



Grupi i Bankës Botërore

1818 H Street NW
Washington, DC 20433 USA

www.worldbank.org

paymentsystems@worldbank.org


Telefon: +1 202 473-1000

Fotoja e kopertinës nga Spencer Montero

© Grupi i Bankës Botërore, 2021

ÇFARË JANË REMITANCAT?

Remitancat janë fonde të transferuara nga emigrantët në vendin e tyre të lindjes. Ato janë kursimet private të punëtorëve dhe familjeve që shpenzohen në vendin e lindjes për ushqim, veshmbathje dhe shpenzime të tjera dhe që drejtojnë ekonominë familjare. Këto pagesa janë zakonisht ndërkufitare.



PSE JANË TË RËNDËSISHME REMITANCAT?

Remitancat janë një nga burimet më të zakonshme të të ardhurave në vendet me nivele të larta emigrimi. Sipas Bankës Botërore¹, në vitin 2019, rreth 529 miliardë dollarë u dërguan në vendet me të ardhura të ulëta dhe të mesme. Ky numër pritet të rritet në të ardhmen.

Remitancat gjithashtu mund të kenë efekte të rëndësishme në ekonominë e vendit pranues. Duke pasur parasysh që remitancat janë praktikisht një pjesë e të ardhurave të dikujt, ndikimi dhe rëndësia e tyre ekonomike është shpesh e dyfishtë. Ato ndikojnë në statusin financiar të buxhetit personal të një individi dhe statusin financiar të pranuesit dhe familjes së tij. Gjithashtu ato ndikojnë edhe në fluksin ekonomik të vendit marrës përmes investimeve, aktivitetit ekonomik dhe konsumit.

¹Raporti i Bankës Botërore për Migrimin dhe Zhvillimin 2019.



PSE JANË TË RËNDËSISHME REMITANCAT?

Mbështetja financiare për buxhetin e ekonomisë familjare të individit zakonisht mundëson aftësi më të madhe financiare, pra rrit konsumin dhe redukton varfërinë duke rritur të ardhurat e popullsisë.

Në të njëjtën kohë, remitancat ndikojnë në zhvillimin ekonomik të vendit marrës: pasi ato përdoren praktikisht për investime dhe prokurime (p.sh. lëndët e para për punëtori, blerja ose rinovimi i pasurive të patundshme, investime të tjera). Ato gjithashtu ndikojnë në rritjen e përgjithshme të prodhimit, tregtisë, tregut të punës, pasuritë e paluajtshme dhe segmentet e tjera të ekonomisë vendore.



REMITANCAT NË KOSOVË

Remitancat janë shumë të rëndësishme për Kosovën dhe diasporën e saj, si në aspektin monetar ashtu edhe në atë kulturor. Në Kosovë, shumica e remitancave të pranuar përmes kanaleve të rregulluara në vitin 2019 ishte 1.24 miliardë dollarë ose 15.6% e PBB-së, sipas Bankës Botërore². Shuma totale supozohet të jetë edhe më e madhe pasi shumica e remitancave transferohen përmes kanaleve të parregulluara (dërgesat personalisht, përmes ndërmjetësve si drejtuesit e autobusëve, etj.).

Nga pikëpamja kulturore, remitancat shpesh konsiderohen simbol i dashurisë dhe përkushtimit të një emigranti për familjen e tij/saj, dhe në shumë raste edhe për familjen e tij/saj të gjerë. Emigranti ndjen një detyrim moral për të dërguar para në shtëpi, pavarësisht nga nevoja. Në mënyrë të ngjashme, përfituesit presin dërgesa nga anëtarët e familjes së tyre të ngushtë ose të afërmit jashtë vendit.

Si rezultat, pjesëtarët e diasporës kosovare dërgojnë para në shtëpi për sa kohë që ata jetojnë jashtë, në shumë raste edhe në kohezgjatje prej 40 vitesh, brez pas brezi. Pothuajse çdo familje kosovare ka disa të afërm jashtë vendit duke pasur parasysh historinë sociopolitike të vendit dhe pothuajse çdo familje merr mbështetje financiare nga jashtë.

²Të dhënat vjetore të Bankës Botërore për Migrimin dhe Remitancat



REMITANCAT NË KOSOVË

Për më tepër, në shumë raste, emigrantët vendosin të mbajnë dhe menaxhojnë financat e tyre në Kosovë si një mënyrë për të mbajtur lidhje me vendin e tyre të lindjes ose për të pasur një mundësi të hapur për t'u kthyer në Kosovë në të ardhmen. Ndonjëherë, anëtarët e familjes në Kosovë menaxhojnë financat e të afërmeve të tyre jashtë vendit së bashku me pasuritë e tyre, si shtëpitë ose bizneset.

Pavarësisht nga vendi i banimit, lidhja me familjet në shtëpi mbetet e fortë ndër breza dhe emigrantët vijnë për vizitë të paktën një herë në vit. Përderisa Zvicra, Gjermania dhe Mbretëria e Bashkuar përbëjnë pjesën më të madhe të fluksit të remitancave në vend, shumë qytetarë kosovarë kanë emigruar në vendet fqinje si Sllovenia, Bosnja dhe Hercegovina dhe Serbia.



RËNDËSIA E REMITANCAVE PËR INDIVIDËT DHE FAMILJET

Remitancat janë një burim i rëndësishëm i të ardhurave për individët dhe familjet për të përmbushur nevojat e tyre themelore. Për më tepër, remitancat shërbejnë si një portë hyrëse për përfshirjen financiare. Me një provë zyrtare të të ardhurave të qëndrueshme nga remitancat, individët kualifikohen për të marrë hua dhe gjithashtu ka më shumë të ngjarë të përdorin shërbime të tjera financiare, të tilla si llogari rrjedhëse, llogari kursimesh, etj.

Grupi i Bankës Botërore hulumtoi shprehitë financiare të dërguesve dhe përfituesve të remitancave në një mostër përfaqësuese në Kosovë. Remitancat në Kosovë përdoren kryesisht për konsum, pagesa faturash, kujdes shëndetësor, rinovime të shtëpive, arsim dhe qëllime investimesh.



CILËT JANË FAKTORËT E ZAKONSHËM QË NDIKOJNË NË ZGJEDHJEN E NJË KANALI PËR TRANSFER PARASH?

Kriteret kryesore që zakonisht ndikojnë në një vendim janë:

- ✓ Shpejtësia;
- ✓ Siguria;
- ✓ Shprehitë;
- ✓ Niveli i njohurive financiare;
- ✓ Përfshirja financiare dhe qasja e shërbimeve financiare;
- ✓ Procedurat administrative;
- ✓ Kostoja

“Remittance Prices Worldwide” është një shërbim online i themeluar nga Grupi i Bankës Botërore që synon rritjen e transparencës dhe disponueshmërisë së informacionit për remitancat dhe kostot e transfereve ndërkufitare të parave. Faqja monitoron gjithsej 367 "korridore" midis 48 vendeve dërguese dhe 105 vendeve pritëse.

Më shumë informacion është në dispozicion në:
<https://remittanceprices.worldbank.org/>.



REMITANCAT DHE INVESTIMET

Përkundër besimit popullor, remitancat ndonjëherë mund të përdoren si kapital investimi për fillimin e një ndërmarrje ose një biznesi. Nëse jeni përdorues i remitancave, përpiquni të mos e shihni veten thjesht si një përfitues ose një konsumator. Analizoni në mënyrë aktive opsionet tuaja që “paratë të punojnë për ju” dhe për të përdorur më mirë remitancat, dhe kështu të përmirësoni statusin tuaj financiar.

Disa nga mënyrat për ta arritur këtë janë: duke qenë i mirëinformuar, duke ndjekur edukimin financiar, duke u përfshirë financiarisht, duke analizuar produktet dhe shërbimet financiare në dispozicion, dhe duke përvetësuar mendime dhe aftësi ndërmarrësie.



PËRFSHIRJA FINANCIARE E PËRDORUESVE TË REMITANCAVE

Shkurtimisht, përfshirja financiare përfaqëson pjesën e individëve që përdorin produkte dhe shërbime financiare në treg (hua, kursime, llogari bankare, etj.).

Përdorimi i një llogarie bankare ose kanaleve të rregulluara të transferit të parave për të pranuar remitancat ju lejon qasje më të lehtë në produkte dhe shërbime të tjera financiare në treg.

Këshillë:

Si një përdorues i remitancave, duhet të pyesni për kanale të ndryshme, sigurinë dhe çmimet e shërbimeve të transferit të parave. Ndërprisni praktikat që janë të këqija ose thjesht jo mjaft të mira për ju. Edukoni veten në lidhje me bazat e edukimit financiar dhe mësoni rreth produkteve dhe shërbimeve financiare të disponueshme në treg. Përmes edukimit financiar, ju merrni informacion dhe njohuri që mund të përmirësojnë ndjeshëm statusin tuaj financiar.



MOS HARRONI!

1. Remitancat mund të përdoren në disa mënyra - për investime, konsum, kursime, fillimin e një biznesi, etj. Merrni parasysh mundësitë tuaja përpara se të vendosni për mënyrën më të mirë për ju dhe familjen tuaj.
2. Siguria, shpejtësia dhe kostoja janë kriteret kryesore për të vendosur se si të transferohen remitancat. Mënyra më e lirë shpesh nuk është më e sigurt ose më e shpejta, dhe anasjelltas. Prandaj, është thelbësore të merren parasysh nevojat, opsionet dhe rreziqet kur merrni vendimin.



MOS HARRONI!

3. Kur pyetni për një produkt financiar ose një shërbim, merrni parasysh dërgesat e parave si burimin tuaj të aftësisë paguese ose një instrument sigurie kur negocioni me institucionin financiar.
4. Mos e konsideroni veten vetëm si një përfitues apo konsumator të thjeshtë dhe analizoni në mënyrë aktive opsionet tuaja që "paratë të punojnë për ju".





BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

**Banka Qendrore
e Republikës së Kosovës**

Adresa: Rr. Garibaldi nr. 33,
Prishtinë, Kosovë

www.bqk-kos.org

E-mail: info@bqk-kos.org

Telefon: +383 38 222 055

Fax: +383 38 243 763



THE WORLD BANK

IBRD • IDA | WORLD BANK GROUP

Grupi i Bankës Botërore

1818 H Street NW
Washington, DC 20433 USA

www.worldbank.org

paymentsystems@worldbank.org

Telefon: +1 202 473-1000